

URDHËR

**-Rregulla për liçensimet, organizatat e trajnimeve,
seksionet aeromjekësore, AMC dhe AME**

Në përputhje të artikullit 102, paragrafit 4 të Kushtetutës dhe Artikullit 7, paragrafi C të Ligjit 10040 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” dhe referuar Urdhrit 66 të datës 8 Qershor 2011.

Urdhër

Implemetimi dhe aplikimi i plotë i kërkesave themelore të vendosura në JAR FCL 1, 2 dhe 3 si më poshtë:

TABELA E PËRMBAJTJES

Kapitulli 1 – Liçensimi i ekuipazhit fluturues

- Art 1.1 – Shkurtime dhe përkufizime
- Art 1.2 – Kushtet e përgjithshme
- Art 2 – Kufizimet e moshës
- Art 3 – Vlefshmëria e licensave JAR-FCL dhe të ICAO-s
- Art 4 – Konvertimi i licensave që s’bëjnë pjesë në JAA
- Art 5 – Aftësia e gjuhës angleze
- Art 6 – Trajnimi i pilotave, testimi dhe kontrolli
- Art 7 -- Apelimi dhe detyrimi
- Art8 -- Formatimi i liçensës

Kapitulli 2- Kurset e trajnimit JAR-FCL dhe Organizatat e trajnimit

- Art 9 - Trajnimet teorike dhe praktike –kushte të përgjithshme
- Art10 - FTO
- Art 11 - TRTO
- Art 12 – Qëndrat e regjistruara

Kapitulli 3- Kërkesa mjekësore dhe implemetimi i procedurave të JAR-FCL 3

- Art 13 - Kërkesa mjekësore –kushte të përgjithshme
- Art 14 - Seksioni aeromjekësor- AMS
- Art 15 - Qëndrat aeromjekësore -AMC
- Art 16 - Ekzaminuesit mjekësor të autorizuar - AME
- Art 17 -Seksioni aeromjekësor (AMS) dhe konfidencialiteti mjekësor (udhëzimi 95/46 1995 i EU)
- Art 18 – Procedura për përjashtime mjekësore
- Art 19 - Procedurat e rishikimit mjekësor
- Art 20 – Rishikimi dytësor për vlerësimin mjekësor

Kapitulli 4 – Kualifikimi dhe trajnimi i inspektorëve të FCL

- Art21 - Trajnimi i inspektorëve të AAC

Kapitulli 5- Dispozitat përfundimtare

- Art22 - Survejimi
- Art23 – Hyrja në fuqi

KAPITULLI I LICENSIMI I EKIPIZHIT FLUTURUES

Art 1 – Përkufizime

AME - Ekzaminuesi mjekësor i autorizuar nga AAC për lëshimin e çertifikatës mjekësore e cila nevojitet për mbajtjen e liçensës së pilotit

AMC - Qendra aeromjekësore e autorizuar nga AAC për lëshimin e çertifikatës mjekësore që nevojitet për të fituar apo mbajtur një licencë piloti

AMS - Seksioni aeromjekësor i AAC

ICAO Aneks I – Është Aneksi i Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar i mbajtur në Çikago në 7 Dhjetor të 1944

Konvertimi (i një liçense) –Lëshimi i një liçense JAR-FCL në bazë të një liçense të lëshuar nga një ish-shtet jo antar i JAA

Kordinatori kombëtar i liçensimit –Personi i emëruar nga Autoriteti i Aviacionit Civil Kombëtar që kordinon me grupin e standartizimit mjekësor dhe të liçensimit.

Liçensë – dokument i vlefshëm i lëshuar nga AAC i cili autorizon mbajtësin të ushtrorë funksionet si pjestar i personelit të kabinës në bordin e një avioni civil të regjistruar në Shqipëri.

Autoriteti liçensues- autoriteti i përcaktuar si përgjegjës për liçensimin e personelit dhe konkretisht AAC.

Klasifikim –një autorizim i regjistruar ose i shoqëruar me një liçensë, i cili përbën një pjesë të saj, që deklaron kushte specifike, privilegje apo kufizime që i përkasin kësaj liçense.

Pranimi i liçensave- nënkupton aktin e konvertimit apo vlerësimit nga AAC, të një liçense të lëshuar nga një Shtet tjetër, së bashku me privilegjet dhe çertifikatat që i përkasin. Pranimi që mund të realizohet përmes lëshimit nga AAC të një liçense të saj nuk do të kalojë kufizimin kohor të vendosur nga liçensa origjinale.

Pilot privat- Një pilot i cili mban një liçencë që ndalon pilotimin e avioneve në operime të cilat paguhen.

Pilot profesional- Një pilot që mban një liçensë që lejon pilotimin e një avioni të përfshirë në operime të cilat paguhen.

Kontrollet e aftësisë- Demonstrimi i aftësive për të rivlerësuar apo ripërtërirë klasifikimet që përfshin provimin teorik ashtu siç mund të kërkohet nga Ekzaminuesi

Testet e aftësisë- Demonstrimi i aftësive që nevojitet për lëshimin e liçensës apo që përfshin provimin teorik ashtu siç mund të kërkohet nga Ekzaminuesi

Vlefshmëria –Akti i kryer nga AAC si një alternativë për të lëshuar liçensën e saj, duke pranuar një liçensë të lëshuar nga një Shtet kontraktues të ICAO-s si ekuivalente e liçensës.

Çertifikatë mjekësore- Dokument çertifikues i aftësisë mendore dhe fizike për fitimin apo mbajtjen e liçensës së pilotit

Konfidencialiteti mjekësor – Kufizimi i hyrjes në informacionin mjekësor personal të mjekëve të AMS dhe stafit të tyre mbështetës

Informacioni mjekësor personal – Janë të dhënat dhe raportet mjekësore të paraqitura tek AMS nga mjekët Ekzaminues dhe të tjerë.

JIP-(Procedurat e Përbashkëta të Implentuara) – Material udhëzues dhe administrativ i JAA-- Seksioni V, amendamenti I Tetor 2008.

JAR-FC L- Kërkesat e përbashkëta të Aviacionit në lidhje me Liçensimin e ekuipazhit fluturues. Janë standartet teknike të aplikuara nga Shtetet Anëtare të EASA-s

Art 2 Kushte të përgjithshme

Ky Urdhër mundëson implemetimin e JAR-FCL 1, Amendamenti 7 i datës 1 Dhjetor 2006, JAR-FCL 2, Amendamenti 6 i datës 1 Shkurt 2007 dhe të JAR-FCL 3, Amendamenti 5 i datës 1 Dhjetor 2006 si edhe materiale udhëzuese JIP dhe administrative të JAA Seksioni 5.

JAR-FCL 1 dhe 2 rregullojnë mënyrën sesi aplikantët të fitojnë, rivlerësojnë dhe rinovojnë liçensat dhe klasifikimet për avionë dhe helikopterë si edhe programet e trajnimit, provimet, testet dhe kontrollet për liçensa dhe klasifikime të tilla.

Aplikantët apo mbajtësit e liçensave shqiptare të lëshuara sipas kërkesave të JAR-FCL, në mënyrë që të ushtrojnë privilegjet e lidhura me liçensat dhe klasifikimet e tyre, duhet të mbajnë një certifikatë mjekësore JAR-FCL 3 që i përket kësaj liçense.

Kërkesat e JAR-FCL 1, Amendamenti 7, aplikohen për lëshimin edhe mbajtjen e klasifikimeve dhe liçensave të avionit.

Kërkesat e JAR-FCL2, Amendamenti 6, aplikohen për lëshimin dhe mbajtjen e klasifikimeve dhe liçensave të helikopterit.

2.1 Kufizimet në moshë –Mbajtësi i liçensës i cili ka mbushur 60 vjeç nuk do të veprojë si pilot në një avion që operon si transportues ajror tregëtar përveç se:

- (1) si një anëtar i një ekuipazhi me shumë pilot, dhe nëse
 - (2) një mbajtës i kësaj liçense është i vetmi pilot në ekuipazh i cili ka mbushur moshën 60 vjeçare
- (b) Moshë 65 vjeçare -Mbajtësi i një liçensë i cili ka mbushur 65 vjeç nuk do të veprojë si pilot në një avion që operon si transportues ajror tregëtar.

Art 3. Vlefshmëria e liçensave të ICAO dhe JAR-FCL

Një liçensë piloti e lëshuar në përputhje me Aneksin 1 të ICAO-s nga një Shtet jo ish-Anëtar i JAA mund të vlerësohet si subjekt i kushteve të vendosura nga AAC Shqiptare në mënyrë që ti lejohet të fluturojë (përveç se në fluturime mësimore) në avionë të regjistruar në Shqipëri, sipas rregullave dhe procedurave të përmendura në JAR-FCL dhe të zhvilluara në procedurat operative të AAC Shqiptare.

AAC pranon, pa vonesa apo testime shtesë, çdo liçensë të lëshuar nga një ish-Anëtar i JAA bashkë me privilegjet dhe certifikatat që bëjnë pjesë në të, duke lëshuar një certifikatë vlefshmërie. Kjo certifikatë do të tregojë Shtetin e lëshimit të liçences origjinale, numrin, datën e lëshimit dhe të skadencës së liçensës JAR-FCL.

Art 4. Konvertimi i liçensave të shteteve jo-anëtare të JAA

Konvertimi i një liçense profesionale, përveç liçensës JAR-FCL, në liçensë të lëshuar nga AAC Shqiptare mund të bëhet në rast se ekziston një marrëveshje paraprake ndërmjet AAC Shqiptare dhe Shtetit Anëtar të ICAO-s.

Kjo marrëveshje me Shtetin jo-Anëtar të JAA do të tregojë se ku janë diferencat ndërmjet dy sistemeve të liçensimit dhe kushtet për konvertim.

Një liçensë e konvertuar sipas kësaj marrëveshjeje do të ketë një shënim në të, e cila do të tregojë Shtetin Jo-Anëtar të JAA mbi të cilin është mbështetur konvertimi. Privilegjet dhe kufizimet e këtij konvertimi do të jenë ato të cilat tregohen në kërkesat e JAR-FCL.

Të njëjtat kërkesa do të aplikohen për konvertimin e një liçence JAR FCL, deri sa Shqipëria do të njihet për lëshimin e liçensave të saj.

Art. 5 Aftësia e gjuhës angleze

Që nga 5 Marsi 2008, të gjithë mbajtësit e liçensave që do të pilotojnë avionët e regjistruar në Shqipëri, në të cilët kërkohet përdorimi i radio telefonisë duhet të kenë një vërtetim të aftësisë së gjuhës angleze të përfshirë në license apo në vlefshmërinë e liçencës .

AAC Shqiptare nuk do të vlerësoj një liçensë pa nivelin e gjuhës angleze së paku në nivelin 4 të vërtetuar, apo në rast se vërtetimi i gjuhës ka skaduar.

Pëvetësimi i gjuhës Angleze që do të kërkohet duhet të paktën të jetë në Nivelin Operacional 4.

AAC Shqiptare do të njohë për mbajtësit e liçensave një çertifikatë të aftësisë së lëshuar nga një organizatë nëse:

- 1- Organizata ka eksperiencë paraprake në vlerësimin e gjuhës angleze për pilotat, sipas kërkesave të ICAO-s (në këtë rast do të jetë aprovuar nga AAC Shqiptare) apo
- 2- Organizata ka një aprovim të veçantë nga një Autoritet i një Shteti tjetër ish Anëtar të JAA.
- 3- Një Shtet i tillë ka dorëzuar planin e implementimit apo ka bërë të njohur pëmbushjen e tij të plotë me kërkesat e ICAO-s (FISX web site).

AAC Shqiptare nuk do të njohë nivelin e aftësisë së gjuhës të vendosur në liçensën e pilotit nga një Shtet Anëtar i ICAO-s, në rast se Shteti nuk përmbush plotësisht kërkesat e ICAO-s apo nuk ka bërë të njohur planin e implementimit tek ICAO.

Art. 6 Trajnimi i pilotëve, testimi dhe kontrolli

I gjithë trajnimi teorik dhe praktik do të kryhet në organizatat e aprovuara të trajnimit, sipas kërkesave JAR-FCL.

AAC Shqiptare do të pranojë trajnimin, testimin dhe kontrollin e kryer sipas kërkesave të JAR-FCL dhe në përputhje me to vetëm në rast se kushtet e këtij aktiviteti janë të barabarta ose mbi minimumin e kushteve të përshkruara në këtë rregullore.

Art. 7 Apelimet dhe Detyrimet

AAC Shqiptare në çdo rast, në përputhje me procedurat e saj kombëtare, mund të apelojë, të kufizojë, apo të pezullojë dhe të revokojë një licensë, klasifikim, autorizim apo certifikatë që është lëshuar sipas kërkesave të JAR-FCL, nëse konstatohet se aplikanti apo mbajtësi i liçensës nuk ka plotësuar apo plotëson kërkesat e JAR-FCL apo ligjin përkatës kombëtar.

Në rast se AAC Shqiptare konstaton se aplikanti apo mbajtësi i liçensës JAR-FCL të lëshuar nga një Shtet Anëtar tjetër i JAA nuk ka plotësuar apo nuk plotëson rregullat e JAR-FCL apo ligjin kombëtar përkatës të Shtetit në të cilin përdoret avioni, AAC Shqiptare do të njoftojë Shtetin e lëshimit të licenses.

Kur një aplikim për liçensë ose klasifikim është refuzuar apo është dhënë në terma të tjera nga ajo që është kërkuar, aplikanti mund të kërkojë që rasti të rishihet nga AAC Shqiptare.

Gjithashtu, një aplikant i cili ka dështuar në testimin apo provimin e kërkuar para se ai të marrë apo të ushtrojë privilegjet e liçensës ose klasifikimit, mund të kërkojë që AAC Shqiptare të shqyrtojë nëse provimi apo testi janë kryer saktësisht.

Art. 8 Modeli dhe formularët e liçensës dhe certifikatës mjekësore

Formulari dhe modeli i liçensave të fluturimit do të jenë në përputhje ato të JAR-FCL.

I njëjti model përdoret për lëshimin e certifikatës së vlefshmërisë, duke pasur parasysh se ky informacion jepet në formular.

Të gjitha liçensat, vlefshmëritë dhe njohjet do të lëshohen me firmën e Drejtorit të DSA.

Klasifikimet do të lëshohen, rivlerësohen dhe rinjihen me firmën e inspektorit të liçensimeve.

Formulari dhe modeli i certifikatës mjekësore do të jetë në përputhje me JAR-FCL 3.

Për qëllim të lëshimit, rinjohjes apo rivlerësimit do të përdoret një formular i certifikatës mjekësore që është në JIP JAA AGM Seksioni 5.

KAPITULLI II PROÇEDURAT PËR APROVIMIN E KURSEVE TË TRAJNIMIT DHE ORGANIZATAVE TË JAR-FCL

Art 9. Trajnimi praktik dhe teorik

Kushte të përgjithshme Trajnimi teorik dhe praktik për lëshimin, rivlerësimin dhe rinjohjen e licensave, klasifikimeve dhe autorizimeve do të jepen nga Qëndrat e Regjistruara, Organizatat e Trajnimit të Fluturimit dhe Organizatat e Trajnimit të Klasifikimit sipas Tipit, të cilat janë të regjistruara apo të aprovuara nga AAC shqiptare ose nga një Shtet ish Anëtar i JAA, sipas kërkesave dhe programeve të trajnimit të aprovuara nga AAC Shqiptare duke siguruar se trajnimi është i barabartë ose mbi minimumin e kushteve të përshkruara në këtë Urdhër dhe rregullave të sjella që bazohen në të.

AAC shqiptare do të japë aprovimin dhe regjistrimin e qëndrave dhe të organizatave trajnuese vetëm pas vlerësimit të përpunueshmërisë së tyre me rregullat e JAR FCL dhe me kërkesat që rrjedhin nga rregullat kombëtare.

Aprovimi i Organizatave dhe kurseve të Trajnimit do të jepet nga AAC shqiptare pas kompletimit të aplikimit të veçantë dhe pas inspektimeve të pranueshme.

Rivlerësimi i aprovimit mund të jepet nga AAC shqiptare pas inspektimeve të pranueshme.

Inspektimet do të bëhen vetëm pasi AAC shqiptare të jetë dakord se aplikimi i bërë do të jetë i pranueshëm.

Nëse një Organizatë Trajnimi bën marrëveshje me Organizata Trajnimi të tjera ose përdor baza aerodromesh alternative si pjesë e organizimit të trajnimit të përgjithshëm, këto organizata të tjera do të veprojnë konform kërkesave përkatëse të JAR FCL nën përgjegjësinë e organizatave të tjera dhe do të jenë të disponueshme për inspektim.

Art 10: Organizatat për trajnimin e fluturimeve (FTO)

Një Organizatë Trajnimi e Fluturimit është një Organizatë e pajisur dhe e organizuar që operon në një ambient të përshtatshëm duke ofruar trajnime fluturimi dhe/ apo instruksione fluturimi simulues dhe/ apo instruksione njohurie teorike për programe trajnimi të vecanta.

Kur FTO është vendosur jashtë territorit shqiptar, do të paraqesë një domosdoshmëri për të pasur një aprovim nga AAC Shqiptar.

Kur menaxhimi kryesor i FTO është vendosur në Shqipëri, dhe ambientet e trajnimit janë si brenda dhe jashtë territorit shqiptar, që funksionojnë nën drejtimin e Kreut të Trajnimit, atëherë aplikimi do të bëhet direkt në AAC shqiptare.

Art 11: Organizata e Trajnimit të Klasifikimit sipas Tipit (TRTO)

Një Organizatë Trajnimi të Klasifikimit sipas Tipit është një Organizatë e pajisur dhe e organizuar që operon në një ambient të përshtatshëm duke ofruar trajnime të klasifikimit të tipit dhe/ apo trajnime të bashkëpunimit të ekuipazhit (MCC) dhe/ apo instruksione fluturimi simulues dhe në rast se aplikohet, instruksione teorike për programues të trajnimeve të veçanta.

Art 12: Qendrat e Regjistruara

Një Qendër e Regjistruar është një qendër që siguron trajnime teorike dhe praktike për lëshimin e liçensës të pilotave privat dhe klasifikimeve që lidhen me to.

Për më tepër, një Qendër e Regjistruar mund të aprovohet për të dhënë kurse trajnimi për pilotët e planerëve, për balonë dhe për pilotë të specifikuar (navigator) të kategorive të veçanta ashtu edhe për klasifikimet përkatëse.

KAPITULLI III
KËRKESAT MJEKËSORE DHE
IMPLEMENTIMI I PROÇEDUARAVE TË JAR FCL-3

Art 13. Kërkesat mjekësore

Kushte të përgjithshme –në mënyrë që të aplikohen apo të ushtrohen privilegjet e liçensës që është pranuar për vlerësim nga AAC shqiptare, aplikanti apo mbajtësi i liçensës duhet të ketë një certifikatë mjekësore të lëshuar me kushtet e JAR FCL-3 të përshtatshme me privilegjet e licenses dhe duhet jetë i aftë mendërisht dhe fizikisht të ushtrojë në mënyrë të sigurtë privilegjet e liçensës së aplikueshme.

Janë 2 klasa të certifikatës mjekësore JAR

-Klasa 1 JAR për liçensa piloti profesionale

-Klasa 2 JAR për liçensa piloti privat

Ekzaminimi fillestar i Klasit 1 JAR FCL kryhet në Qendrën Aeromjekësore në Tiranë.

Me aplikimin e mbajtësit të certifikatës mjekësore të klasit 1 JAR FCL të lëshuar në një Shtet Tjetër, AAC Shqiptare do të njohë këtë certifikatë mjekësore pa teste të mëtejshme.

Art 14 Seksioni Aeromjekësor (AMS)

Duke konsideruar shtrirjen e aktiviteteve të aviacionit civil në Shqipëri, në përputhje me JAR FCL3, një nga Ekzaminuesit Aeromjekësor të aprovuar, do të jetë i autorizuar të veprojë në emër të AAC Shqiptare si (AMS) Seksion Aeromjekësor.

Konfidencialiteti mjekësor do të respektohet në cdo kohë. AAC Shqiptare do të sigurojë se të gjitha raportet me shkrim apo me gojë dhe informacioni i ruajtur elektronikisht në çështje mjekësore, të mbajtësit apo aplikuesit të liçensës, do të vihen në dispozicion të (AMS) Seksionit Aeromjekësor, (AMC) Qendrës Aeromjekësore dhe Ekzaminuesit Aeromjekësor që përdorin aplikimin për qëllim të plotësimit të një vlerësimi mjekësor.

Aplikanti apo mjeku i tij do të kenë akses tek i gjithë dokumentacioni në përputhje me ligjin kombëtar.

Art 15 Qendrat Aeromjekësore (AMC)

Qendrat Aeromjekësore do të përcaktohen dhe autorizohen, dhe/ose riautorizohen nga AAC Shqiptare për një periudhë jo më tepër se 3 vjet.

AAC Shqiptare do të vendosë numrin e Qendrave Aeromjekësore që i nevojiten duke marrë parasysh numrin e vlerësimeve që kryen.

Art 16 Ekzaminuesit mjekësor të autorizuar (AME-të)

AAC Shqiptare do të përcaktojë dhe autorizojë AME-të, Ekzaminuesit mjekësor të autorizuar, brënda kufijve të saj, të kualifikuar dhe të liçensuar në degën e mjekësisë dhe të trajnuar në mjekësinë e aviacionit në përputhje me JAR FCL3. Një Ekzaminues mjekësor do të jetë i autorizuar për një periudhë jo më shumë se 3 vjet.

AAC Shqiptare do të vendosë numrin e Ekzaminuesve që i nevojiten, duke marrë parasysh numrin dhe shpërndarjen gjeografike të piloteve të saj.

Art 17 Seksioni Aeromjekësor (AMS) dhe konfidencialiteti mjekësor (direktiva e EU 95/46 1995)

Konfidencialiteti mjekësor duhet të respektohet në cdo kohë.

AMS- Seksioni Aeromjekësor ka përgjegjësi vetëm brënda AAC Shqiptare në lidhje me çështjet mjekësore.

Stafi i punësuar për të mbështetur AMS, do të jetë i autorizuar nga AMS për të hyrë në informacionet personale mjekësore.

AAC Shqiptare do të sigurojë se të gjitha raportet të shkruara ose jo dhe informacioni i ruajtur elektronikisht në çështjet mjekësore të mbajtësve/aplikantëve janë në dispozicion të AMC, AME dhe AMS që merren me aplikimin dhe për qëllim të plotësimit të vlerësimit mjekësor. Aplikanti dhe mjeku i tij do të kenë akses tek i gjithë dokumentacioni në përputhje me ligjin kombëtar.

Masa të përshtatshme sigurie do të vendosen për të siguruar se vetëm personeli i autorizuar do të ketë akses në të dhënat mjekësore kur është e justifikueshme nga kushte të veçanta. AMS mundet që pjesë të caktuara të raportit mjekësor t'i bëjë të disponueshme për zyrtarë të tjerë, në përputhje me ligjin kombëtar.

Të dhënat mjekësore mund të ruhen aq gjatë sa është e nevojshme në përputhje me ligjin kombëtar.

Një sistem i koduar sigurie do të aktivizohet për të siguruar dokumentet e transmetuara dhe të ruajtura elektronikisht.

Art 18 Procedura për përjashtime mjekësore

Përjashtimet mjekësore aprovohen nga Drejtori Ekzekutiv i AAC Shqiptare që ndjek propozimet nga AMS, vetëm në rastin kur përjashtimet nuk ulin nivelin e sigurisë.

Përjashtimet mjekësore mund të jepen sipas procedurave të Seksionit II të JAR FCL 3.

Art 19 Procedurat e rishikimit mjekësor

Nëse një aplikant nuk përmbush kushtet e JAR FCL Nën pjesa B dhe C mund t'i kërkohej një rishikim nga Seksioni Aeromjekësor sipas shtojcave të këtyre nën pjesëve. Nëse aplikantit i është dhënë një certifikatë mjekësore pas një procedurë rishikimi nga AMS cdo kufizim që mund të kërkohej do të shënohet në certifikatën mjekësore sipas Seksionit V të JIP JAA AGM.

Ky shënim do t'i lejojë që cdo (AME) Ekzaminues mjekësor i autorizuar të jetë në dijeni të rishikimit të mëparshëm të AMS, në rast se kushtet apo instruksionet e vecanta aplikohen dhe të kontaktojë AMS për më tepër informacione kur është e nevojshme.

AMS mund të vlerësojë si te përshtatshëm aplikantët që nuk plotësojnë kërkesat e JAR FCL 3 Nënpjesa B ose C, por që janë në përputhje me kërkesat e Shtojcave.

Nëse aplikantit i është dhënë apo i është refuzuar një çertifikatë mjekësore pas një procedure rishikimi, aplikanti, AME ose AMC do të njoftohet nga AMS në lidhje me vendimin final me shkrim.

Vlerësimet e përshtatshmërisë do t'i delegohen AMC ose AME me zgjedhje të AMS. Në rast të vlerësimeve të përshtatshmërisë, AMS do të informohet për detajet e këtij vlerësimi.

Për më tepër, AMS mund të revokojë një vlerësim të tillë, nëse vihet re që nuk përputhet me kërkesat e JAR FCL 3 ose me ligjin përkatës kombëtar.

Art 20 Rishikimi i dytë për vlerësimin mjekësor

Një procedurë për rivlerësimin e dytë do të krijohet nga AAC Shqiptare me këshillues të pavarur mjekësor me eksperiencë në fushën e mjekësisë së aviacionit për të vlerësuar dhe konsideruar rastet e diskutueshme.

KAPITULLI IV TRAJNIMI DHE KUALIFIKIMI I INSPEKTOREVE TË FCL

Art 21 Trajnimi i inspektoreve të AAC

Të gjithë inspektoret duhet të trajnohen, kualifikohen dhe duhet të kenë eksperiencën e tyre të nevojshme në varësi të rolit që ata kanë.

Megjithatë, pavarësisht eksperiences dhe begraundit, një inspektor duhet të mësojë dhe nga përvoja e personelit më të vjetër në organizatë.

Trajnimi për Inspektoret do të përfshijë, së paku instruksione si më poshtë në varësi të rolit që ata kanë:

- (i) kërkesat kombëtare që lidhen me detyrat e tyre të inspektimit
- (ii) Dokumentat dhe Aneksat e ICAO-s që lidhen me detyrat e tyre
- (iii) JAR FCL, JAR-et dhe JIP-et (Procedurat e përbashkëta të implementimit) që lidhen me to.
- (iv) Sistemi i cilësisë që lidhet me JAR FCL;

Kushte të metejshme paraprake, trajnimi fillestar dhe periodik do të tregohet në procedura të tjera.

**KAPITULLI V
DISPOZITA FINALE**

Art 22 Mbikqyrja

AAC Shqiptare merr përgjegjësinë e mbikqyrjes dhe implemetimit të këtij Urdhri dhe ekzekutimin e tij nga të gjithë subjektet që operojnë në fushën e Aviacionit Civil.

Art 23 Hyrja në fuqi

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë pas publikimit të tij të plotë dhe do të zëvendësojë apo shfuqizojë çdo urdhër paraardhës që trajton të njëjtën çështje.